



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 935/2 Prot.
2024

Tiranë, më 10 . 07 .

V E N D I M

Nr. 197, datë 10 . 07 . 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 139 Regj., datë 20.06.2024, të z. A. K, kundër Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”³.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar formularit të ankesës së depozituar pranë KMD-së, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjekti ankues, z. A. K, parashtroi se:

“Kam aplikuar për legalizimin e shtëpisë para 16 viteve. ASHK Shkodër më ka dërguar në Gjykatë sepse thuhet se janë djegur dokumentet për shtëpinë para vitit 1991. Tre kufitarët e mi që

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Subjekti ankues, sipas Dëshmisë së Invalidit të Punës nr.800, lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë, me afat përdorimi një vit: 31.12.2023-31.12.2024, ka shkallë invaliditeti të plotë.

janë xhaxhallarët e mi, i kanë marrë certifikatat e pronësisë për pronat para 1991 dhe vetëm unë jo.

Gjykata e Apelit Shkodër ka urdhëruar Bashkinë Shkodër të kryejë regjistrimin dhe kërkesën time bashkë me dokumentacionin e kam paraqitur pranë Bashkisë Shkodër. Pas 4 vitesh trajtim në Bashki, dosja kaloi tek Drejtoria përkatëse për legalizimet dhe që nga ai moment nuk kam marrë asnjë përgjigje nga ASHK Shkodër. Unë pretendoj se diskriminohem për shkak të aftësisë së kufizuar.”

Në përfundim të ankesës së tij, subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Ndalimin e diskriminimit dhe marrjen e legalizimit”.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga këqyrja e dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vëren se:

Nëpërmjet Vendimit nr. 2816, datë 14.12.2006, Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, ka disponuar, ndër të tjera: *“Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin F. K, vdekur me datë 06.12.1995, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë, gruan S si dhe fëmijët A. K, R. K, D. K, të cilët trashëgojnë nga 2/10 pjesë takuese secili, ndërsa 2 (dy) trashëgimtarët e të ndjerës Z. K (U) trashëgojnë nga 1/10 pjesë takuese secili.”*

Referuar Vendimit nr. 650, datë 18.11.2013, të Gjykatës së Apelit Shkodër, evidentohet si më poshtë vijon:

Subjekti ankues, A. K, ka paditur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Zyrën Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, me objekt: *“Detyrimin e palës së paditur ZVRPP Shkodër të pajisë me certifikatë pronësie A. K për pasurinë nr. 7/180 vol., zona kadastrale 8594, me sipërfaqe 294 m² dhe sipërfaqe banimi 64.6 m².”*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me Vendimin nr. 717, datë 31.03.2011, ka vendosur për rrëzimin e kërkesë-padisë së paditësit A. K.

Kundër këtij Vendimi paditësi A. K, ka bërë ankimim në Gjykatën e Apelit Shkodër, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe pranimin e kërkesë-padisë për detyrimin e palës së paditur ZVRPP Shkodër ta pajisë me certifikatë pronësie për pasurinë me nr. 7/180 vol., zona kadastrale 8594.

Pas shqyrtimit të ankimimit të ankuesit, Gjykata e Apelit Shkodër, me Vendimin nr. 650, datë 18.11.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, duke arsyetuar, ndër të tjera se: *“Sipas VKM-së respektive “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të trullit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, pronari rezulton se duhet të ndjekë rrugën administrative të parashikuar në këtë VKM, me qëllim që të kryejë regjistrimin e pronës në ZVRPP Shkodër.*

...sipas nenit 137/3, të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet në parim, se, palët e interesuara mund t'i drejtohen Gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ, ndërsa sipas pikës 13, të VKM-së nr.608/2012, përcaktohet se çdo mosmarrëveshje që lind gjatë zbatimit të këtij vendimi, ankimohet në gjykatë sipas ligjit.

...Gjykata e Apelit vlerëson se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, pasi paditësi duhet të ezaurojë më parë rrugën administrative dhe kërkesa për regjistrim duhet të trajtohet administrativisht më parë nga Institucioni i autorizuar, e më pas, në rast refuzimi, ai duhet t'i drejtohet me padi gjykatës”.

Nëpërmjet shkresës me nr. 280/1 prot., datë 21.02.2024, DV ASHK Shkodër i është drejtuar z. A. K, lidhur me informimin e tij si palë e interesuar, mbi gjendjen e procedurave administrative të aplikimit nr. 188, datë 16.10.2018, duke cituar se:

“...Sikurse Ju kemi informuar me shkresën me nr. 1415/1 prot., datë 20.07.2023, është bërë kërkesa drejtuar Sektorit të Regjistrimit për të parë nëse ka akte të regjistrueshme sipas nenit 193, të Kodit Civil dhe ligjit nr. 20/2020, për pasurinë 7/180, 7/133 zk 8594, Bashkia Shkodër në arkivën e DV ASHK Shkodër.

Sipas verifikimit të statusit juridik pasuria e pretenduar 7/133, 7/180 rezulton në emër të F. K dhe Q. K.

Pas verifikimeve dhe të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesi, vërtetimi i pronësisë me nr. radhori pronësie nr. 34, datë 06.03.1973, rezulton në emrin e F. K. Ndodhur në këto kushte ju orientojmë të përcillni dëshminë e trashëgimisë së F. K dhe Z. K.

Deri në plotësimin e mangësive nuk mund të procedohet në vendimmarrje”.

DV ASHK Shkodër, thekson faktin se subjekti A. K deri më datë 21.02.2024⁴, nuk ka përcjellë dëshminë e trashëgimisë që është kërkuar dhe në këtë rast nuk mund të vazhdohet me procedurat administrative deri në plotësimin e mangësive të shprehura më sipër.

Në analizë të gjithë sa më sipër, Komisioneri vëren se:

Së pari, pretendimi i ankuesit se, Gjykata e Apelit Shkodër ka urdhëruar Bashkinë Shkodër (strukturat e posaçme pranë saj) ta pajisë me certifikatë proësie atë, për pasurinë nr. 7/180 vol zk 8594, me sipërfaqe 294 m² dhe sipërfaqe banimi 64.6 m², nuk qëndron, pasi, referuar Vendimit nr. 650, datë 18.11.2013, Gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se z. K, para se t'i drejtohet gjykatës, duhet të ezaurojë ankimimin administrativ sipas përcaktimeve respektive ligjore.

Së dyti, nga përgjigjet e kthyer nga DV ASHK Shkodër drejtuar ankuesit, organit epror të saj ASHK-së, por edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, konstatohet se arsyeja e mosregjistrimit të pronës së pretenduar nga ankuesi është se ai nuk ka depozituar dokumentacionin përkatës, për të cilin është njoftuar që paraprakisht duhet ta plotësojë dhe vetëm pasi të plotësohen mangësitë në dokumentacionin e dorëzuar prej tij, mund të procedohet me vendimmarrje nga ana e tyre. Komisioneri evidenton faktin se, kopja e dëshmisë së trashëgimisë, depozituar pranë KMD-së si provë, rezulton të jetë tërhequr pranë Gjykatës nga ankuesi, me datë 15.04.2024.

Ligji nr. 20/2020 *“Për proceset kalimtare të pronësisë”*, përcakton procedurat dhe organin shtetëror përgjegjës për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore, të regjistrimit të titujve të pronësisë për pasuritë e paluajtshme në pronësi shtetërore dhe private në Republikën e Shqipërisë, si dhe të inventarizimit, transferimit, trajtimit dhe regjistrimit përfundimtar të tyre.

⁴ Kopja e kësaj dëshmie, depozituar pranë KMD-së si provë, rezulton të jetë tërhequr pranë Gjykatës nga ankuesi, me datë 15.04.2024.

Në nenin 34/6, të këtij Ligji, përcaktohet se: *“Rregullat e hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë për këto pasuri përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”*

Akti nënligjor në zbatim të sa më sipër, VKM nr. 827, datë 30.09.2020 *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim”*, përcakton procedurën e plotë që duhet ndjekur nga pala e interesuar për regjistrimin e pronës.

Në nenin 66, të Ligjit, *“Ankimi administrativ dhe gjyqësor”* është përcaktuar në mënyrë të detajuar se:

- “1. Struktura e posaçme për ankimet administrative, e ngritur sipas legjislacionit për kadastrën shqyrton ankimet administrative ndaj akteve dhe ndaj veprimeve ose mosveprimeve administrative të ASHK-së, që kanë të bëjnë me proceset kalimtare të parashikuara në këtë ligj.*
- 2. Ankimi administrativ ushtrohet dhe shqyrtohet në përputhje me afatet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ankimi drejtpërdrejt në gjykatë. Vendimi i nxjerrë në bazë të ankimit administrativ, që shfuqizon, anulon, deklaron pavlefshmërinë, ose ndryshon përmbajtjen e aktit administrativ që është regjistruar, pasqyrohet në seksionin e pronësisë së kartelës së pasurisë së paluajtshme.*
- 3. Kundër vendimit të strukturës së posaçme për shqyrtimin e ankimeve administrative mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative...”*

Bazuar në sa më sipër dhe dokumentacionin e depozituar nga palët⁵, lidhur me pretendimin e ankuesit për mosregjistrimin e pronës nga ana e DV ASHK Shkodër, Komisioneri vëren se, **së pari, ankuesi ka mangësi të dokumentacionit të dorëzuar pranë DV ASHK Shkodër, dhe në këto kushte fillimisht duhet të plotësojë mangësitë në dokumentacion dhe t'i depozitojë pranë DV ASHK Shkodër, dhe nëse pas dorëzimit të dokumentacionit mund apo do të ketë pretendime lidhur me veprimet apo mosveprimet e kësaj Drejtorie Vendore, sikurse parashikohet në nenin 66, të ligjit nr. 20/2020 *“Për proceset kalimtare të pronësisë”*, (përfshirë edhe analizën ligjore e konkluzionet e Vendimit nr. 650, datë 18.11.2013, të Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila ka disponuar me pushimin e gjykimin të çështjes, pikërisht për shkak se ankuesi nuk ka ezauruar fillimisht rekursin administrativ, bazuar në dispozitat respektive ligjore⁶) për mosregjistrimin e pronës së tij, ai duhet të ndjekë ankimin administrativ në strukturat e posaçme të ASHK-së, pasi pretendimet e tij supozohet se mund të gjejnë zgjidhje që aty.**

⁵ Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë KMD-së nga ankuesi, por edhe përgjigjet shkresore të DV ASHK Shkodër, drejtuar ankuesit, ASHK-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

⁶ Citojmë nga Vendimi i gjykatës: *“...Neni 137/3, i Kodit të Procedurës Administrative”*.

Nëse ankuesi nuk do të jetë dakord as me vendimin e strukturës së posaçme për shqyrtimin e ankimeve administrative/ ASHK, mund të paraqesë ankim në gjykatën kompetente, për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje administrative.

Në këto kushte, bazuar në sa më sipër, **Komisioneri i rekomandon subjektit ankues, që, për problematikën e tij, (në rastin kur pretendon se ka dorëzuar dokumentacionin e plotë pranë DV ASHK Shkodër dhe nga kjo strukturë nuk pajiset me certifikatë pronësie) të shterojë fillimisht rekursin administrativ, sipas parashikimeve përkatëse ligjore, pranë strukturave të posaçme/ASHK dhe në rast të mosdakordësisë edhe me vendimmarrjen e këtij të fundit, mund t'i drejtohet Gjykatës, për të adresuar pretendimin e tij për detyrimin e DV ASHK Shkodër për regjistrimin e pronës së tij⁷.**

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektit ankues, që, për problematikën e tij, t'i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore (QSHNJP) Shkodër, me adresë: Rruga “Don Bosko”, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr. 139 Regj., datë 20.06.2024, të subjektit ankues A. K, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

⁷ Për analogji citojmë (pjesa së dyti), Vendimin nr.50, datë 20.02.2024, të KMD-së.

Robert GAJDA